



REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE I VITIT 2023

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	30.01.2023	A ka lidh kontrata me qira Bashkia Fier në Njësitë Administrative Dërmënas dhe Topojë në tokat bujqësore të pandara apo toka pa frut (PF)? 2-Sa kontrata janë lidh dhe kur? 3-Për çfarë aktiviteti janë lidh? 4- A janë ndërtuar stacione fotovoltaike në këto zona dhe cili është pronari pranë ku janë ngrit këto stacione? 5-Si janë ndarë tokat e ish-kooperativave dhe ndërmarrjeve bujqësore në territorin e Njësive Dërmënas dhe Topojë?	06.03.2023	1-Pas Reformës Territoriale dhe Administrative nga Njësia Administrative Topojë nuk ka lidhur asnjë kontratë për tokat bujqësore të pandara dhe pa frut se nuk kanë kompetencë ligjore. 2-Në Njësitë nuk ka dokumentacion për ndërtimin e stacioneve fotovoltaike. 3-Tokat disponibël shtetërore pavarësisht se ndodhen në territorin e Njësive administrohen nga Ministria e Bujqësisë. 4-Tokat e ish-kooperativave dhe NB-ve, janë ndarë nga ish-komisionet e ndarjes së tokave në bazë të ligjit nr.7501 dhe sipas regjistrit të gjendjes civile familjet e të cilave janë pajisur me AMTP në pronësi dhe përdorim.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.807/2 prot.	Pa pagesë

2	31.01.2023	Inormacion për të dhënat nga Plani Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Fier, në zonën Sheq i Madh	24.02.2023	Kopje e shkresës nr.9769/1, dt.11.11.2022, informon se: Zona ka pasaport nr.74, kodi 1/167. Përdorimi bazë: Banim kati 1-100%, kati 2-0% kati 3-0% Përdorime të tjera: industri dhe ekonomi përveç magazinave me produkte jo ndojte apo ushtarake. Karburante me kushtëzime që të kenë zonë mbrojtje 60 m përreth tyre. Tipologjia: Vila Nuk ak plan rrugor dhe PDV: e paparishikueshme.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.846/1 prot.	Pa pagesë
3	08.02.2023	Informacion nëse ka ndonjë praktikë nga përmabrimi apo gjykata për pagesë pension ushqimor për çështjen F.R. me Sh.Z.	20.02.2023	Për çështjen ka tre njoftime ankandesh të regjistruar në Bashki me nr.5307 prot, datë 16.06.2022, me nr.6042 prot, datë 12.07.2022, nr.6714 prot, datë 09.08.2022. Gjithashtu dhe një shapllje publike të Gjykatës Apelit Vlorë me nr.10423, datë 30.11.2023.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.1238/1 prot.	Pa pagesë

4	22.02.2023	Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit për kërkesën e A.K. 1-Sa impiante për trajtimin e ujërave të ndotura ka ndërtuar Bashkia Fier? 2-Sa janë funksionalë? 3-Çfarë kategorie është niveli i trajtimi të ujërave të ndotura?	07.03.2023	Bashkia e Fierit nuk ka refuzuar dhënien e informacionit, por meqë ky informacion duhet të jepet nga Shoqëria e Ujësjetës Kanalizimeve, kërkesa është përcjellë atje. U kërkojmë ndjesë për mosfunksionimin email-it zyrtar dhe njëherazi ju informojmë se Bashkia Fier nuk ka impiante për trajtimin e ujërave të ndotura.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.1752/1 prot.	Pa pagesë
5	15.03.2023	Informacion mbi procedurën që duhet ndjekur për t`u pajisur me leje për rregullim/riparim çatie dhe dokumentacionin që duhet të dorëzoj aplikanti	24.03.2023	Në bazë të VKM nr.408, datë 13/05.2023, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", I ndryshua, neni 8, pika b, për tu pajisur me leje për deklarata paraprake (tek e leje rregullim/riparim çatie) duhet të jeni të pajisur me çertifikatë pronësie ose leje legalizimi.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.2333/1 prot.	Pa pagesë

6	24.04.2023	Kërkojmë të informohemi se a është parashikuar nga Bashkia Fier zgjerimi i rrugës "Kastriot Muço" apo jo? Në parashikohet ky zgjerim a mund të të na përcaktoni nëse preket objekti?	18.05.2023	Për të përcaktuar vendodhjen, si dokument shoqërues, duhet të përcillet edhe vërtetimit mbi statusin e përfshirjes së këtij objekti në proces legalizimi me planvendosjen përkatëse, pasi ky objekt nuk figuron në hartën treguese të çertifikatës së pronës.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.3521/3 prot.	Pa pagesë
7	02.05.2023	Kërkojmë të informohemi dhe kopje në lidhje me projektin e ndërtimit të një pallati në rrugën "Llambi Çibuku", Fier. Planin e ndërtimit dhe lejen. Katet dhe distancat e qarta të dukshme në plan dhe çdo dokument tjetër të rëndësishëm.	07.07.2023	Nuk legjitimohet sepse nuk ka lidhje me çështjen dhe mostrajtimi i kësaj kërkesë për shkak edhe të kufizimeve të përcaktuara në nenin 17, të të ligjit nr,119/2014, " <i>Për të drejtën e informimit</i> "	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.3777/1 prot.	Pa pagesë
8	08.05.2023	Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit për kërkesën e A.KF 1-Nëse Bashkia e Fierit disponon arkivë apo regjistra, apo cfarëdo lloj, ku të jenë pasqyruar pagesat e tatimit për biznesin e vogël (sipas ligjit me nr.7679 të vitit 1993), nga ambulatët e tregut industrial poshtë urës së lumit Gjanica, në vitet 1992-2009? 2-Nëse po, të dhëna për pagesat e tatimit të biznesit të vogël (sipas ligjit 7679 të vitit 1993) të prindërve M. K dhe S. K., duke bashkëlidhur dokumentat përkatëse	10.05.2023	Bashkia e Fierit nuk disponon në Arkiv regjistra apo formularë ku të jenë dokumentuar pagesat e tatimit të biznesit të vogël, nga ambulatët e ish-tregut që funksiononte poshtë urës së lumit Gjanica, në vitet 1992-2009.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.3995/1 prot.	Pa pagesë

9	31.05.2023	Informacion apo dokumentacione mbi pagesa dhe shtrirjen e vendvarrimeve në Varrezat Publike Fier, të viteve 1990-2003.	04.07.2023	Nuk disponojmë dokumentacione për faturimet dhe hartat e shtrirjes së vendvarrimeve të atyre viteve.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.4671/1 prot.	Pa pagesë
---	------------	--	------------	--	---	-----------

10	22.06.2023	Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit për kërkesën e D.Xh. 1-Sa është numri i rojeve bregdetare ne Plazhin e Semanit? 2-Sa është numri i kullave të vrojtimit në Plazhin e Semanit? 3-A ka ky plazh zona të rezikshme dhe të panjohura (përshembull gropa)? 4-Nëse keni shifra, sa është numri i personave që zgjedhin të pushojnë në këtë plazh gjatë sezonit veror? 5-Nëse keni shifra, sa është numri i pushuesve që kanë humbur jetën në këtë plazh? 6-Cilat janë masat që priten të merren nga Bashkia Fier për t`u ardhur në ndihmë pushuesve për sigurinë në plazhe gjatë vitit 2023? 7-Sa herë është pastruar vija bregdetare e këtij plazhi gjatëperiudhës 2020-2023?	23.06.2023	1-Në plazhin publik të Semanit kemi dy vrojtues-roje të çertifikuar sipas kërkesave të ligjit. 2-Numri i kullave të vrojtimit në plazhin e Semanit është një. Për pikat 3, 4 dhe 5 nuk disponojmë informacion. 6-Me shkresën nr.125 prot., datë 15.03.2023, ka dalë Urdhri Kryetari të Bashkisë Fier në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Urdhri i Kryeministrit nr.20, datë 01.03.2023 "Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të Sezonit turistik Veror 2023" ku janë përcaktuar të gjitha masat që ndërmerren për këtë sezon. 7-Pastrimi, jo vetëm i këtij plazhi, kryhet në mënyrë periodike gjatë gjithë periudhës Prill-Shtator.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.5407/1 prot.	Pa pagesë
11	30.06.2023	Kërkojë informacion nëse ka apo jo ndonjë projekt Bashkia Fier, që prek pasurinë të treguar në hartën të nxjerrë nga sateliti?	12.07.2023	Refuzohet kërkesa për mangësi dokumentacioni	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.55679/1 prot.	Pa pagesë

12	13.07.2023	Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit për kërkesën e A.Sh. 1-Sa është numri i shkollave në bashkinë tuaj? 2-Sa ka qënë numri i nxënësve në 9-vjeçare, në vitin shkollor 2021-2022 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar në klasën e parë? 3-Sa ka qënë numri i nxënësve në 9-vjeçare, në vitin shkollor 2022-2023 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar në klasën e parë? 4-Sa ka qënë numri i nxënësve në gjimnaz, në vitin shkollor 2021-2022 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar në vitin e parë? 5-Sa ka qënë numri i nxënësve në 9-vjeçare, në vitin shkollor 2022-2023 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar në klasën e parë? 6-Sa shkolla janë mbyllur për gjatë viteve 2021-2023?	18.07.2023	1-Numri i shkollave publike në Bashkinë Fier është 54, nga të cilat 2 janë profesionale. 2- Për pikat nr.2, nr.3, nr.4, nr.5, nr.6, ky lloj informacioni nuk përpunohet nga Bashkia Fier, por nga një institucion tjetër. Bazuar në nenin 12, të ligjit 119/2014, "Për të drejtën e informimit" kërkesa juaj i përcillet edhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.6086/1 prot.	Pa pagesë
13	18.09.2023	Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit për kërkesën e Qendrës Res Publika në lidhje me: 1-Sa është numri total i familjeve/individëve që trajtohen me ndihmë ekonomike? 2-Sa është numri total i familjeve që përfitojnë nga ndihma bllok 6%?	21.09.2023	1-Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga sistemi, është 556 familje dhe kategori në nevojë. 2- Numri i familjeve/individë që përfitojnë nga 6%, është 63 familje/individë.	Përfunduar. U dha informacioni me shkresë nr.8060/1 prot.	Pa pagesë

14	06.10.2023	<p>Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit për kërkesën e J.P. në lidhje me: 1-Ka Bashkia Fier një plan/studim/dokument lidhur me planin e njoftuar nga Kryetari i Bashkisë Fier, Armando Subashi për ndërtimin e një tregu bashke kohor për tregtimin me shumicë të produkteve bujqësore? Nëse po, lutemi na vini në dispozicion dokumentin në fjalë. 2-Lutemi na vini në dispozicion projektin për rehabilitimin e qendrës së Libofshës. 3-Lutemi na vini në dispozicion procedurën dhe dokumentacionin përmes së cilës është dhënë kjo kontratë publike. 4-Cila është kompania që ka fituar të drejtën për ndërtimin e qendrës së Libofshës? Sa kushton ky investim? Kur ka filluar puna dhe kur parashikohet të përfundojë? 5-Lutemi të na vini në dispozicion dokumentat/projektin/panin e punës për ndërtimin e rrugës nga Manastiri i Ardenicës deri në Kishën e Shën Gjergjit në Libofshë dhe drejt Manastirit të Shën Kozmait sipas premtimit të Kryetarit të Bashkisë. 6-Kur ka nisur puna për rehabilitimin e infrastrukturës rrugore në Njësinë Levan? Lutemi të na vini në dispozicion dokumentacioni përkatës të projektit si dhe kontratën e lidhur me kompaninë që zbaton projektin. 7-Kur</p>	07.11.2023	<p>1-Për pikën nr.1, Bashkia Fier është në fazë studimi për ngritje e një tregu bashkohor të produkteve bujqësore. 2-Për pikat nr.2, nr.3, dhe nr.4, Projektii "Rehabilitimi i Qendrës së Libofshës" është ende në procedurë leje dhe për aq kohë sa projekti nuk ka marrë financime, pra nuk është në fazën e realizimit/zbatimi, autorët në mbrojtje të së drejtës së krijimit, nuk mund t`a afrojnë për publikun. 3.- Për pikën 5, hartimi i projekt-plani për ndërtimin e rrugës që do të lidhë Manastirin e Ardenicës me Kishën e Shën Gjergjit në Libofshë është i kushtëzuar me miratimin dhe realizimin e projektit të "Rehabilitimi i Qendrës së Libofshës". 4-Për pikat nr.6 dhe nr.7 puna për rehabilitimin e infrastrukturës rrugore në Njësinë Administrative</p>	Përfunduar. U dha informacioni me email për shkresën nr.8940/1 prot.	Pa pagesë
----	------------	--	------------	--	--	-----------

15	17.10.2023	Dua një koment për projektin që parashikohet të ndërtohet tek Sheshi "Fitorja", pranë Kishës Orthodokse. Cili është projekti që parashikohet të implementohet tek godina që do të prishen? Si do të procedohet me banorët që nuk kanë ranë dakort me kompesimin që ka propozuar Bashkia?	23.10.2023	1-Në lidhje me pikën e parë të kërkesës ju informojmë se në zbatim të VKM-së nr.125 datë 03.03.2021 "Përshpronësi min për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga realizimi projektit "Rehabilitimi i lumit Gjanica, rikonceptimi i Qendrës së qytetit dhe Ndërtimi i Stadiumit të Lojërave me dorë Fier", IVMT Bashkia FIER, në datë 14.08.2023 ka vijuar me procedurat e ekzekutimit të prishjeve, sipas njoftimeve që janë kryer më përpara sipas listës së pronarëve. 2-Në lidhje me pikën dy, banorët që preken nga zbatimi i kësaj VKM-je kanë paraqitur ankim në Gjykatën kompetente dhe në asnjë rast nuk ka vendim pezullimi të zbatimi të kësaj VKM-je, por në raport me vlerat e	Përfunduar. U dha informacioni me email për kërkesën nr.9242/1 prot.	Pa pagesë
----	------------	--	------------	--	--	-----------

16	23.10.2023	<p>1-Cila është situata aktuale e ecurisë së punës së incenerimit nga kompania Integrated Technology Waste Treatment Fier? 2-Numrin total të punonjësve të kompanisë ITWT së bashku me organikën sipas kategorive të ndryshme të punonjësve? 3-Numrin e punonjësve të kompanisë ITWT që janë me kontrata pa afat, si dhe numrin e punonjësve me kontratë pune me afat të përcaktuar? 4-Nga kush paguhen punonjësit dhe nga sigurohen fondet për pagat e tyre? 5-A ka mbaruar investimi në incenerator? Nëse jo, kur ka qënë afati për përfundimin e investimeve? 6- A është aktualisht në funksion inceneratori? Në qoftëse jo, për çfarë arsye nuk funksionon dhe kur parashikohet të vihet në funksion? 7-Kur ka qënë afati për vënien në punë të Inceneratorit? 8-A përfitojnë para pronarët/aksionerët e inceneratorit të Fierit? 9-Sa është çmimi që paguan Bashkia për kapsulim për ton/mbetje? 10-A do të paguajë përsëri për ç` kapsulimin e tyre dhe kalimin në incenerator, kur ky të vihet eventualisht në funksion? 11- Ku depozitohen në vazhdimësi mbetjet e Bashkisë nqs Inceneratori nuk funksionon? 12-A do të nxirren nga kapsulimi mijëra ton mbetje, që kapsulohen në gropa rreth Inceneratorit</p>	15.11.2023	<p>Në përgjigjen nga Ndërmarrja e Pastrimi informohet se Inceneratori i Fierit, aktualisht, administrohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara e cila është përgjegjëse e gjithë mabrevajtjes së punës së Inceneratorit. Bashkia e Fierit bën vetëm depozitimin e mbetjeve urbane pranë Landfillit të Inceneratorit.</p>	<p>Përfunduar. U dha informacioni për kërkesën nr.9405 prot, me shkresën nr.801prot të Ndërmarrjes Pastrimit.</p>	<p>Pa pagesë</p>
----	------------	---	------------	--	---	------------------

17	30.10.2023	<p>Ankimi ndaj refuzimit të dhënies së informacionit për kërkesën nr.7040 prot, datë 16.08.2023, në lidhje me lejet e ndërtimit të dhëna në territorin e Bashkisë Fier, për periudhën 1 janar 2015-31 maj 2023, duke individualizuar: a-numrin e lejeve të ndërtimit; b-datën e lejes së ndërtimit; c-subjektin ndërtues dhe apo investitor; d-sipërfaqen ndërtimore të përcaktuar në lejen e ndërtimit; e-vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë; f-subjektin që ka realizuar pagësën e taksës së ndikimit në infrastrukturë; g-datën e pagesës së saj; h-institucionin financiar nëpërmjet të cilës është realizuar pagesa</p>	10.11.2023	<p>Duke u referuar zbatimit të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar ku citohet : "Me kërkesën e tij, këshilltari informohet dhe i vihet në dispozicion në çdo kohë, nga Kryetari i Bashkisë përkatëse, çdo dokumentacion i lidhur me bashkinë", si dhe në "Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Këshillit të Bashkisë Fier", të miratuar me VKB nr.11, datë 27.01.2017, në nenin 15, citohet «1. Këshilltarët e Bashkisë që duan të marrin informacione të nevojshme për kryerjen e funksionit gjatë mandatit të tyre, i drejtohen në çdo kohë Sekretarit të Këshillit të Bashkisë, përgjegjësve të ndërmarjeve apo institucioneve në varësi të Bashkisë, por edhe Kryesisë së Këshillit, apo drejtorive të shoqërive të përbashkëta për aktet e të cilave Këshilli i Bashkisë duhet të shprehet. 2. E drejta dhe konsultimi vlen për të gjitha aktet e administratës së Bashkisë. 3.</p>	Përfunduar. U dha informacioni për kërkesën nr.7040 prot me shkresën nr.9730/1 prot.	Pa pagesë
----	------------	---	------------	---	--	-----------

18	11.12.2023	<p>1-A është konsultuar me publikun Buxheti Vjetor 2023 dhe 2024 Bashkisë? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/eve për zhvillimin e dëgjësive publike, kur dhe ku është publikuar njoftimi/njoftimet...2-A është konsultuar me publikun paketa e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2023-2024? Nëse po, kur dhe ku është publikuar njoftimi/et...3-A është konsultuar me publikun tjetërsimi i pronave të Bashkisë për periudhën Janar 2023- Dhjetor 2023? Nëse po, kur dhe ku është publikuar njoftimi/et...4-A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/eve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/et.5-A janë njoftuar paraprakisht në faqen e internetit ose stendën e informimit data dhe ora e mbledhjeve të Komisioneve të Këshillit Bashkiak, për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023? Nëse po, më përcillni kopje të njoftimit/eve për zhvillimin e këtyre mbledhjeve, kur dhe ku është publikuar njoftimi/et...6-A shfaqen në faqen e internetit apo stendën e njoftimeve publike. nioftimet për organizimin e</p>	20.12.2023	<p>1-Konsultime për Buxhetin vjetor 2023-2024 të Bashkisë Fier janë bërë transparente për publikun në faqen e web të Bashkisë Fier nelinkun.https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/d-publike-tetor.pdf . Njoftimet janë publikuar gjithashtu edhe ne faqen e fb-Bashkia e Fierit. 2-Njoftimi për zhvillimin e dëgjësive publike është publikuar në faqen e fb Bashkia e Fierit (Njoftimi mban datën 20 Tetor 2023 bashkengjitur edhe kalendari takimeve), gjithashtu publikimi është bërë edhe në faqen e WebSite-it https://bashkiafier.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/d-publike-tetor .pdf 3-Nuk ka pasur vendimarrje për tjetërsim të pronave ne Bashkine Fier për periudhën janar 2023-dhjetor 2023. 4- Njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të paqyruara në faqen e web-it https://bashkiafier.gov.al/njof</p>	Përfunduar. U dha informacioni me e-mail për kërkesën e bërë në info@bashkiafier.gov.al .	Pa pagesë
----	------------	---	------------	--	--	-----------